



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

KABINETI I MINISTRIT
KABINET MINISTRA
THE CABINET OF MINISTER

**Fjalimi i ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, Lutfi Zharku në punëtorinë
"Politikat tregtare", të organizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe UNDP-ja,
në "Hotel Grand" - Prishtinë,**

Prishtinë, 25 qershor 2009

I nderuar zt. Dewaulf,
Zonja dhe zotërinj,

Kam kënaqësinë të ju paraqes versionin e plotësuar të Dokumentit për Politikën Tregtare së Kosovës, i cili i paraqet elementet bazë të vizionit tonë për politikën tregtare. Unë shkurt do të trajtoj vetëm disa nga çështje kryesore të Dokumentit kurse Dr. Gashi do të bëjë një prezantim me të hollësishëm pak më vonë.

Bilanci negativ tregtar është njëra ndër sfidat më të rëndësishme ekonomike me të cilin po përballet Kosova. Ne jemi të vetëdijshëm se ndryshimi i këtij realiteti kërkon qasje gjithëpërfshirëse ekonomike the politike dhe reforma për të ndryshuar ambientin operacional në Kosovë, me qëllim të përmirësimit të pozicionit konkurrues të Kosovës në tregun botëror. Kosova është një ekonomi e hapur; pjesëmarrja e eksportit dhe importit në BPV (apo niveli i hapjes së tregut) ishte pothuajse 0.6 në vitin 2008.

Që nga viti 1999 ekonomia kosovare ka pasur një rritje relative të ulët pavarësisht rritjes shumë të lartë në vitin e parë të periudhës së pasluftës, ndonëse prej një baze shumë të ulët. Edhe pse gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm makroekonomik për të ringjallur ekonominë kosovare, ende ka sfida tjera të mbetura. Ashtu siç edhe e ceka në fillim, një indikator i tillë është deficitin e lartë tregtar, i cili po vazhdon që nga fundi i vitit 1999. Importi është shumë i rëndësishëm për Kosovën duke marrë parasysh që përbën rreth 50% të BPV-së, kurse trendet ekonomike tregojnë që është vështirë të priten ndryshime të mëdha brenda një periudhe të shkurtër kohore.

Eksporti në periudhën e pasluftës ka shënuar një rritje impresive (mesatarisht mbi 60% në vit për periudhën 2001-2008). Një pamje më premtuese paraqitet nëse merret parasysh i ashtuquajturit eksport 'virtual' - i cili përfshin konsumimin e prezencës ndërkombëtare në Kosovë - sipas të cilës eksporti i mbulon 20% të importit, e cila në llogaritë nacionale konsiderohet si 'eksport për shërbime'.



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA**

**MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY**

**KABINETI I MINISTRIT
KABINET MINISTRA
THE CABINET OF MINISTER**

Për periudhën e njëjtë, edhe importi ka shënuar një rritje të theksuar në mesatare prej 15% në vit. Në vitin 2008, importi ka arritur shifrën prej gati 2 miliardë euro, ndërsa eksporti ka qenë afër 200 milion euro. Edhe pse shkalla e mbulimit të importit është ende shumë e ulët, ajo është rritur vazhdimisht që nga viti 2001, duke u dyfishuar në vitin 2007 dhe 2008, duke arritur në 10.5 gjegjësisht 10.2%.

Një lajm i mirë në anën e importit është se struktura e importit është duke ndryshuar në mënyrë të favorshme. Në mes të viteve 2005 dhe 2008 pjesëmarrja e mallrave ndërmjetëse në importin e përgjithshëm është rritur për 3.2%. Po ashtu, pjesëmarrja e mallrave kapitale është rritur vazhdimisht gjatë periudhës së njëjtë. Ky ndryshim kualitativ në strukturën e importit është tregues i trendit të ri të ekonomisë kosovare për ringjalljen dhe forcimin e sektorit prodhues. Kjo tregon se është duke ndodhur një lloj zëvendësimi i importit. Në realitet, kjo tregon tendencën e ekonomisë për t'u mobilizuar në kuptim të nivelit më të lartë të konkurrencës.

Arsyet për një funksionim relativ të dobët të sektorit eksportues në Kosovë janë të shumta dhe të gjitha natyrave; politike, historike dhe ekonomike. Shumica nga këto të meta janë të ndërlidhura me njëra tjetrën; p.sh. për një periudhë të gjatë statusi i pazgjidhur politik ka qenë pengesë për zhvillimin e Kosovës. Në këtë kontekst, ekzistojnë disa faktorë të cilët duhet të veçohen dhe të cilët kanë pasur ndikim në zhvillimin e sektorit të ndërmarrjeve, dhe veçanërisht në sektorin e eksportit. Kosova e pasluftës ka trashëguar industrinë dhe kompanitë pothuaj në një kolaps total si rezultat i shkatërrimit dhe vjedhjes; vonesat dhe shumë komplikime në procesin e privatizimit e kanë bërë rimëkëmbjen e tyre edhe më të vështirë. Në anën tjetër, për shumë vite Kosova nuk ka qenë pjesë e iniciativave regjionale që synonin liberalizimin e tregtisë, kryesisht për shkak të statusit të pazgjidhur politik. Për më tepër, niveli i investimeve të huaja direkte si një faktor i rëndësishëm për të përkrahur eksportin nuk ka qenë i kënaqshëm. Ekonomia joformale gjithashtu është një dimension që duhet të përmendet. Në fund, duhet të theksojmë furnizimin jo të rregullt me energji elektrike dhe infrastrukturën e kufizuar rrugore si pjesë e realitetit Kosovar.

Pavarësisht nga kjo pasqyrë e dhënë, ekziston një perspektivë e qartë për ekonominë kosovare. Një sferë të cilën do ta kisha përmendur është tregu potencial. Mund të thuhet me siguri se potenciali më i madh mbetet ai i tregut të BE-së. Të dhënat nga partnerët tregtarë të Kosovës për vitin e kaluar tregojnë për një tendencë në rritje të bizneseve kosovare për t'u drejtuar drejt tregut të BE-së. Kjo tendencë gjithashtu mund të shihet edhe në vendet e regjionit. Zhvillimi i marrëdhënieve me BE-në është kritik për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Për shkak të madhësisë dhe potencialit absorbues të BE-së, Kosova do të përfitonte nga rritja e kërkesës për produktet e saj në vendet e BE-së dhe me gjasë



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

KABINETI I MINISTRIT
KABINET MINISTRA
THE CABINET OF MINISTER

edhe investimeve potenciale të cilat do të ndodhnin. Këto investime rezultojnë me transferim të njohurive dhe inovacioneve të cilat do të kishin efekt të theksuar pozitiv në ekonominë e Kosovës.

Zonja dhe zotërinj,

Institucionet e Kosovës kanë qenë pjesë e proceseve dhe ndërmarrjeve për liberalizmin e tregtisë në regjion. Kosova ka nënshkruar një numër të marrëveshjeve për tregti të lirë, së pari me Shqipërinë dhe më vonë me Maqedoninë, Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Kroacinë. Në vitin 2006 Kosova është bërë anëtarë e plotë i CEFTA-s. CEFTA sjellë përgjegjësi të caktuara, megjithatë ka edhe shumë aspekte pozitive në këtë proces. Njëri prej këtyre përfitimeve në rend të parë do ishte lëvizja e lirë e mallrave dhe shërbimeve. Qëllimi i CEFTA-s është krijimi i rregullave dhe mekanizmave me të cilët do të drejtohet tregtia e jashtme në regjion. Këto rregulla janë harmonizuar me principet e BE-së dhe OBT-së (Organizata Botërore e Tregtisë). Përvoja e fituar gjatë tregtisë me regjionin do t'i bëjë produktet e Kosovës konkurrenë në tregun e BE-së dhe më gjerë. Gjithashtu, gjatë këtij procesi Kosova do t'i mobilizon institucionet dhe politikat të cilat do të përputhen me kushtet e kërkuara nga OBT. Një tjetër synim i CEFTA-s është krijimi i një tregu atraktiv regional i cili do të krijonte mundësi të reja për bizneset vendore apo investitorët e huaj. Ky dimension është veçanërisht i rëndësishëm për Kosovën, për arsye se investimet e huaja direkte kanë një rëndësi të jashtëzakonshme për të përmirësuar pozitën konkurruese të industrisë kosovare në tregjet e jashtme.

Sa i përket OBT-së, edhe pse të vetëdijshëm që anëtarësimi në të është një proces kompleks, Qeveria e Kosovës e konsideron pranimin në OBT si një hap të rëndësishëm drejt integritimit të plotë në sistemin tregtar botërorë. Përftimet nga anëtarësimi janë të rëndësishme, veçanërisht për vendet e vogla si Kosova, të cilat janë të varura shumë në tregtinë e jashtme, e të cilat mund të përmbliidhen si vijon:

- Kërkesat për anëtarësim në OBT rezultojnë me fuqizimin gjithëpërfshirës të politikave dhe institucioneve të vendit;
- Anëtarësimi në OBT siguron hyrjen në tregjet kryesore botërore. Kosova si një vend në tranzicion do të përfitonte nga klauzola *për kombin më të favorizuar*, që nënkupton trajtim të barabartë apo jo-diskriminues nga vendet anëtare të OBT-së, si dhe,
- Anëtarësimi ofron mundësinë e qasjes në mekanizmat mbi zgjidhjen e kontesteve.

Në përfundim, do të kisha dashur të përsërisë që Kosova, përveç politikave tjera ekonomike,



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA**

**MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY**

**KABINETI I MINISTRIT
KABINET MINISTRA
THE CABINET OF MINISTER**

është e angazhuar për integrim në ekonominë botërore përmes liberalizimit të tregut. Pjesëmarrja në mekanizmat tregtarë regjionalë dhe më gjerë ka qenë njëra nga objektivat kryesorë të politikës së institucioneve të Kosovës si pjesë e procesit të liberalizimit të tregut. Përparimi i tregut në Kosovë përmes liberalizimit të tregut kërkon vendosjen e tri aspekteve: racionalizmin e importit, lehtësimin e tregtisë, dhe promovimin e eksportit.

Zonja dhe zotërinj,

Liberalizmi i tregtisë, si i tillë, nuk është i mjaftueshëm për përparimin e zhvillimit. Janë disa arsye për këtë; së pari, politikat e tregtisë duhet të formulohen, të zbatohen, dhe të vlerësohen në mënyrën e cila i jep më shumë prioritet zhvillimit se sa vetë rezultatit të tregtisë ndërkombëtare. Së dyti, në mënyrë që përfitimi nga liberalizimi i tregtisë të jetë i lartë dhe i qëndrueshëm, duhet të kuptohen dhe menaxhohen mirë jo vetëm politikat e tregtisë por edhe ato politika zhvillimore të cilat janë të lidhura me tregtinë. Në fund, tregtia është një koncept i ndërlidhur i cili ndikon në të gjitha fushat e jetës ekonomike dhe shoqërore.

Të gjitha këto pasqyrojnë domosdoshmërinë e përmirësimit të kualitetit institucional, përfshirë bashkëpunimin dhe koherencën në mes të gjithë aktorëve relevant të cilët e formojnë sistemin e tregtisë së Kosovës. Dokumenti i sotëm do të shërbejë si bazë për adresimin e të gjitha këtyre çështjeve nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si institucion udhëheqës në këtë fushë.

Ju faleminderit për vëmendje!